



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.6, datë 14.06.2022

PËR

**REFUZIMIN E KËRKESËS PËR LEJE “KËRKESË PËR KRYERJE SHPIMI NËNTOKËSOR PËR NXJERRJE UJI (PUS-SHPIMI)”,
SUBJEKTIT “ZIJA RAMUSHI”**


Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

KONSTATOI SE:

1. Në vendndodhjen ku do të kryhet shpimi nëntokësor nga z. Zija Ramushi për qëllime industriale ka një pus ekzistues të hapur nga subjekti.

PËR KËTË ARSYE:

III. Këshilli i Basenit Ujor Erzen, bazuar ne germen (ç), të pikës 14, të Kreut IV, të VKM-së nr.550, datë 15.07.2020, dhe ne vendimin nr.6, datë 12.06.2019, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor”, të Këshillit Kombëtar të Ujit,



VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës për leje për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi), z. Zija Ramushi, me vendndodhje Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë sipas këtyre koordinatave:

X=487950.68

Y=4576073.53

Z=228 m.m.n.d

2. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

